



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.176/21
213/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “Horn & Co.Kosova” SH.P.K. & “Company Murseli” SH.P.K.-Deçan dhe OE “Berisha Com” SH.P.K.-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Company Bejta Commerce” SH.A.; N.P.SH “ElektroniCom”, dhe “Eurocom” SH.P.K.-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-I, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë, më datën: 23.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Horn & Co.Kosova” SH.P.K. & “Company Murseli” SH.P.K.-Deçan dhe OE “Berisha Com” SH.P.K.-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-I, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-I, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

VI. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Horn & Co.Kosova” SH.P.K. & “Company Murseli” SH.P.K.-Deçan dhe OE “Berisha Com” SH.P.K.-Gjakovë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i` u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Horn & Co.Kosova” SH.P.K. & “Company Murseli” SH.P.K.-Deçan dhe OE “Berisha Com” SH.P.K.-Gjakovë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 25.02.2021 me nr. 176/21, dhe me datë 06.03.2021 me nr. 213/21 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtim-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK-Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 parag.1 dhe 3, neni 7 par. 1 dhe, 51, 52 par. 4, 56, 59 par. 2 dhe 4, 60 par. 2, 69 dhe neni 72 të LPP-së, si dhe nenin 41 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 176/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 7, 24 pika 2, 51, 56, 59, si dhe nenin 60 të LPP-së , te ankesa me nr. 213/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.02.2021, me nr. 176/21 dhe me 08.03.2021 me nr. 213/21, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës: 05.03.2021, dhe me 11.03.2021 lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Horn & Co.Kosova” SH.P.K. & “Company Murseli” SH.P.K.-Deçan

Ekspertja Shqyrtuese fillimisht sqaron, se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me Njoftimin për Kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020 dhe me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, mirëpo

pas ankesave dhe vendimit të PSH 370/20 dt. 09.07.2020 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim. Me datë 23.07.2020 AK gjatë procesit të rivlerësimit rekomandon po të njëjtin GOE COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, përderisa prape me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 550/20 dt 28.09.2020 ky aktivitet është obliguar që të kthehet prape në rivlerësim, gjersa me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit AK ka rekomanduar prape GOE të lartpërmendura, gjersa prape me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 1126/20 dt 03.02.2021 ky aktivitet është obliguar prape të kthehet në rivlerësim ku me datë 16.02.2021 AK ka publikuar vendimin duke rekomanduar prape GOE të lartpërmendur, përderisa OE ankuesi "HORN& Co. Kosova" SHPK & Company Murseli SH.P.K. ka bërë ankesë në OSHP me datë 25.02.2021 ku pretendon se GOE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë: 1.Në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 & 9.2 pika a) ku është kërkuar se: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë: a.) Një lugë Ngarkuese -Ndërsa ne pas verifikimit të dokumenteve lidhur me këtë pikë kemi vërtetuar se Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë "COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; N.P.SH. "Eltoni Com" dhe EUROCOM SH.P.K, Nuk e posedojnë asnjë dokument që vërteton që ka Lugë Ngarkuese në pronësi apo me qira. (Këtë e kemi vërtetuar nga dokumentet e marra nga Autoriteti Kontraktues, pas kërkesës për qasje në dokumentet zyrtare).

2.Në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 & 9.2 pika d) ku është kërkuar se: Katër (4) kamionë me konstruksion ndërtim kiper mbi 15t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) - Ndërsa ne pas verifikimit të dokumenteve lidhur me këtë pikë kemi vërtetuar se Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë i ka kampionat në pronësi apo me qira, mirëpo të gjithë këta kampionat ofruar Nuk kanë fare afat valid të regjistrimit (iu ka skaduar regjistrimi) e cila gjë mund të vërtetohet nga CERTIFIKATA E REGJISTRIMITTE AUTOMJETEVE të dorëzuara nga Operatori Ekonomik. 3.Po ashtu gjatë kontrollit dhe shqyrtimit të dokumentacionit kemi hasur edhe në mospërputhje të informatave në Listën e Makinerive dhe dokumenteve të prezantuara nga Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë, sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 & 9.2, ku është kërkuar se: Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër GOE të rekomanduarin lidhur me pajisjet, kampionat dhe dokumentet apo dëshmia e tyre mbi qiramarrjen apo dokumente mbi posedimin e tyre, ekspertja shqyrtuese sqaron se, këto pretendime janë shqyrtuar tri here radhazi ku OSHP ka obliguar AK-në që gjatë procesit të rivlerësimit të kërkojë sqarime konform nenit 72 të LPP-së, dhe po ashtu edhe hera e fundit në vendimin e PSH

1126/20 dt. 03.02.2021 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim duke e obliguar AK-në që lidhur me këto pretendime të kërkoj sqarime. AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarime nga GOE i rekomanduar :

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

Data: 08.02.2021

KOMUNA E GJAKOVËS, Rruga UCK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit kati I-rë Gjakovë

Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K, Madanaj, 50000, Gjakovë, Kosovë

Nr. i prokurimit:	632-20-1610-5-2-1
Nr i brendshëm	632-20-014-S21

Titulli: "Rrërimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera"

I nderuar Z. Bashkim Islarnaj

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, . i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siq janë

- a.) Një lugë Ngarkuese
- b.) Një eskavator (makineri me strukturë rotulloese) me pesë mbi 16t.
- c.) Një eskavator (makineri me strukturë rotulluese) me pesë mbi 16t.
- d.) Kanër kamionu me konstrukcion ndërtim kiper mbi 15t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjeteve i cili ka afat valid të regjistrimit)
- e.) Një rimorkio deri 40t
- f.) Një autovloq mbi 15t
- g.) Një bunduzher mbi 15t

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njëtrën prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (kopje).

SQARIM:

Kërkojmë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së për:

- Kërkojmë nga ana Juaj që për rimorkiot e prezentuara të na dërgoni certifikatë të regjistrimit të automjeteve të cilat kanë afat valid të regjistrimit.

Përgjigja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues dhe në e-mail faton.gutaj@rks-gov.net, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kësaj kërkesë.

Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht.

Me respekt,

Faton Gutaj

GOE i rekomanduar ju ka përgjigjur AK-së në afat ligjor duke i bashkangjitur librezat me validitet.

Ekspertja tutje sqaron se, ky aktivitet siç e potencuam edhe më lartë, është kthyer në rivlerësim ku AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarimet, dhe ka marrë përgjigjet! Meqenëse GOE i rekomanduar është me çmimin më të ulët dhe se kriteret kyçe i plotëson, sa i përket vazhdimit të validitetit të kamionëve, nuk mendoj se duhet të eliminohet, pasi që edhe këtë kriter tani e ka përmbushur, po ashtu në ofertë GOE ka të bashkangjitur edhe një Lopatë ngarkuese së bashku me eskavatorin me zingjirë, e cila është e dokumentuar me DUD Doganor si dhe me faturë të shitblerjes Bejta Commerce Sha dhe Nëntë Vëllezërit SHPK, gjersa sa i përket pretendimit lidhur me dokumentimin e pajisjeve dhe makinerive, në ofertën e GOE të rekomanduarit janë të bashkangjitura marrëveshjet mbi qiramarrjen, marrëveshjet mbi shitblerjen si dhe faturat e blerjeve për pajisjet dhe makineritë përkatëse! Andaj mendoj se vendimi i AK-së të mbetet në fuqi, ndërsa ankesa e OE ankues të refuzohet.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Berisha Com" SH.P.K.-Gjakovë

Ekspertja Shqyrtuese fillimisht sqaron, se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me Njoftimin për Kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020 dhe me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, mirëpo pas ankesave dhe vendimit të PSH 370/20 dt. 09.07.2020 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim. Me datë 23.07.2020 AK gjatë procesit të rivlerësimit rekomandon po të njëjtin GOE COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, përderisa prape me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 550/20 dt 28.09.2020 ky aktivitet është obliguar që të kthehet prape në rivlerësim, gjersa me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit AK ka rekomanduar prape GOE të lartpërmendura, gjersa prape

me shqyrtimin e ankesës në OSHP, PSH 1126/20 dt 03.02.2021 ky aktivitet është obliguar prape të kthehet në rivlerësim ku me datë 16.02.2021 AK ka publikuar vendimin duke rekomanduar prape GOE të lartpërmendur, përderisa OE ankuesi "Berisha Com" SHPK. ka bërë ankesë në OSHP me datë 06.03.2021 ku pretendon se GOE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë: AK gjatë Rivlerësimit nuk i ka marrë për bazë pretendimet tona në lidhje me aneksin që kemi bërë dhe si ka shqyrtuar. Koncerziumi i rekomanduar për shpërbllim me kontratë COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k. është i pa përgjegjshëm, për arsye se këtij koncerziumi i mungojnë këto dokumente të cilat i ka dëshmuar edhe Raporti i Ekspertit si dhe vendimi i OSHP-së. Dokumente të cilat i mungojnë Koncerziumit janë:

Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. "Eltoni Com". Deklaratat Nën Betim të paraqitur në dosjen e tenderit nuk janë të marruara nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe nr. i prokurimit. PSH550/20 i dt:28.09.2020

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Berisha Com" sh.p.k – Gjakovë se gjatë qasjes në dokumentet e konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës "Company Bejta Commerce Sh.A"; N.P.SH. "Eltoni Com"; "Eurocom" Sh.p.k., ku Company Bejta Commerce Sh.A. është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës e shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. "Eltoni Com" dhe deklaratat nën betim të paraqitur në dosje të tenderit nuk janë marrë nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe numri i projektit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se OE Eltoni me datë 15.07.2020 i është drejtuar KRPP-së për interpretim me titull "Kërkesë për interpretim të lidhur me Aneksin 2-Deklarata nën Betim dhe Marrëveshjen e Konzorciumit". Kurse, me datë 29.07.2020 KRPP-ja i kthen përgjigje duke dhënë sqarime lidhur me par. 4 të nenit 59 të LPP-së, 47.19 dhe 47.21 të RRUOPP-së, Konkretisht, KRPP-ja i jep këtë sqarim anëtarit të konzorciumit: "edhe pse për KRPP-ën një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale të dosjes së tenderit, megjithatë sipas paragrafit të lartë cituar Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", Pra ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Ekspertja sqaron se, sa i përket deklaratës nën betim KRPP e konsideron si devijim të vogël, i cili duhet të mbetet në diskrecion të AK-së. Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A në deklaratën e Koncerziumit është me seli në Prishtinë ndërsa në Deklaratën Nën Betim del të jetë nga Komuna e Gjilanit. PSH.370/20 dt: 09.07.2020

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A në deklaratën e Koncerziumit është me seli në Prishtinë ndërsa në Deklaratën Nën Betim del të jetë nga Komuna e Gjilanit. **Paneli shqyrtues** konform ekspertit shqyrtues konstaton se **nuk është i bazuar** ky pretendim për arsye se ky devijim mund të jetë një gabim teknik, por që vërtetohet në Certifikatën e Biznesit.

Deklaratat Tatimore Vjetore i ka paraqitur vetëm kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A ndërsa kompanitë tjera të cilat janë në koncerzium këto dokumente iu mungojnë në Dosjen e Tenderit. PSH. 370/20 i dt: 09.07.2020.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se **Deklaratat Tatimore Vjetore** i ka paraqitur vetëm kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A ndërsa kompanitë tjera të cilat janë anëtare të koncerziumit, këto dokumente iu mungojnë në Dosjen e Tenderit. **Paneli shqyrtues** konform ekspertit shqyrtues konstaton se **ky pretendim është i pa bazuar** sipas dispozitës ligjore të LPP-së neni 71 pika 4, për faktin se në paragrafin e lartpërmendur thuhet se citat: "...Çdo kërkesë vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2.68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit", prandaj në rastin konkrete deklaratën tatimore vjetore e ka dorëzuar njeri nga anëtarët e konzorciumit dhe se vijmë në përfundim se kërkesa e lartcekur është plotësuar nga konzorciumi në fjalë.

Inxh Muhamet Selimi e ka diplomën të pa verifikueshme - nuk lexohet. PSH 370/20 i dt:09.07.2020

Ndërsa **është i pa qëndrueshëm pretendimi i ankuesit sa i përket Inxh inierit Muhamet Selimi**, kjo për faktin se diplomën dhe të gjitha referencat dhe kualifikimet për inxhinierin në fjalë janë të noterizuara dhe janë të vlefshme.

Inxhinierët si Izajdin Sylaj Gjeodeti, është Gjeodet të cilit i ka skaduar Licenca, Ju mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovës. PSH. 1126/20 i dt:03.01.2021

Paneli shqyrtues konform ekspertit Shqyrtues sqaron se: sa i përket Licencës po ashtu AK në Njoftimin për kontratë nuk ka cekur se kërkohet **Licenca valide**, andaj pretendimi **nuk gjendet i bazuar**. Ndërsa sa i përket kontratave të punëtorëve, GOE i rekomanduar ka bashkangjitur kontratat e punëtorëve në E-prokurim me datë 30.11.2020, dhe shihet se kontratat janë valide dhe vërtetohet se këto kontrata kanë qenë para hapjes si dhe nuk paraqesin ndryshim material konform LPP-së dhe Rruopp-së, sepse nuk janë kontrata mbi vepër por janë kontrata pune me kohë të caktuar/pacaktuar të nënshkruara kryesisht për hapjes e cila është e dëshmuar edhe me listën e ATK-së.

Ky koncerzium ka mungesa edhe tek makineritë si:

- 1 Lug Ngarkues Mungon.
- Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim
- Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim
- Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në Dosjen e Tenderit

PSH. 1126/20 i dt:03.01.2021

Si përfundim, Paneli shqyrtues konform ekspertës Shqyrtuese i rekomandon AK-së, që procesin e rivlerësimit ta bëjë konform LPP-së dhe Rruopp-së, duke respektuar vendimet e OSHP-së 370/20 dhe 550/20, gjithashtu sa i përket makinerisë sipas pretendimit të fundit për GOE të rekomanduarin, AK të verifikoj dhe analizoj se a i përmbushin kriteret sipas FDI-së pasi që në ofertën e GOE të rekomanduarit ka më tepër makineri të ofruara se sa që kërkohet nga AK, andaj AK të përqendrohet tek kërkesa sipas FDI-së. Po ashtu në raport të rivlerësimit të bëjë sqarimin e qartë me rastin e eliminimit dhe përzgjedhjes së Ofertuesve, pasi që AK në kërkesat për rishqyrtim të OE ankuesit nuk ka dhënë sqarimet e detajuara dhe përgjigje në pretendimet, me qëllim që ofertuesit/ankuesit të mirëkuptojnë vendimin e AK-së.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër GOE të rekomanduarin lidhur me pajisjet, kampionat dhe dokumentet apo dëshmia e tyre mbi qiramarrjen apo dokumente mbi posedimin e tyre, ekspertja shqyrtuese sqaron se, këto pretendime janë shqyrtuar tri here radhazi ku OSHP ka obliguar AK-në që gjatë procesit të rivlerësimit të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së, dhe po ashtu edhe hera e fundit në vendimin e PSH 1126/20 dt. 03.02.2021 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim duke e obliguar AK-në që lidhur me këto pretendime të kërkoj sqarime. AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarime nga GOE i rekomanduar :

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

Datë: 08.02.2021

KOMUNA E GJAKOVËS, Rruga UCK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit kati I-rë Gjakovë

Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM S.H.P.K, Madanaj, 50000, Gjakovë, Kosovë

Nr. i prokurimit:	632-20-1610-5-2-1
Nr. i brendshëm	632-20-014-521

Titulli: "Rrënim-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera"

Inderuar Z. Bashkim Islamaj

Taleminderit që morët pjesë në procedurën e laetshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhoqur në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në varëdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siq janë

- Një llogë Ngarkuese
- Një ekskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me pesë mbi 16t.
- Një ekskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me pesë mbi 16t.
- Kamion kamion me konstruksion ndërtim kliper mbi 15t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit)
- Një rimorkio deri 40t
- Një autovinc mbi 15t
- Një bunduzher mbi 15t

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njëtrën prej këtyre dokumenteve kopje të libërës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka nënshkruar t'i angazhoj për këtë projekt (kopje).

SQARIM:

Kërkojmë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së për:

- Kërkojmë nga ana juaj që për rimorkiot e prezentuara të na dërgoni certifikatë të regjistrimit të automjeteve të cilat kanë afat valid të regjistrimit.

Përgjigja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues dhe në e-mail faton.gutaj@rks-gov.net, brenda **5 (pesë) ditëve** nga data e kësaj kërkesë.

Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht.

Me respekt,

Faton Gutaj

GOE i rekomanduar ju ka përgjigjur AK-së në afate ligjor duke i bashkangjitur librezat me validitet.

Ekspertja tutje sqaron, të gjitha pretendimet e lartpërmendura nga OE ankuesi kundër të rekomanduarit, po e potencojë prape se i kemi shqyrtuar thuajse tri here radhazi, dhe të gjitha kanë vendime nga OSHP, PSH nr. 550/20 i dt:28.09.2020; PSH nr. 1126/20 i dt.: 03.01.2021, dhe se vlen të ceket se pretendimet lidhur me makineritë janë sqaruar të fundit në vendimin PSH 1126/20 i dt:03.01.2021, dhe mendoj që këto pretendime janë të gjykuara tashmë.

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit kundër AK-së lidhur me arsyet e eliminimit:

Në këtë Rivlerësim AK Komuna e Gjakovës edhe ne si Koncerzium “Berisha Com”Sh.p.k & “Joos & Krasniqi-Bazë”Sh.p.k na eliminon për arsye si: 1.Keni prezantuar inxhi. Diplomuar të Ndërtimtarisë (Xhavit Jasiqi) me kontratë të rregullt si të punësuar primar dhe i njëjti është i punësuar në KK-Junik në punë të rregullt zyrtare. Përgjigje I: z.Xhavit Jasiqi Inxhi. i Diplomuar i Ndërtimtarisë është i punësuar në kompaninë “Berisha Com”Sh.p.k ku mund ta shihni edhe në listën e pagave nga Administratë Tatimore e Kosovës, sa i përket kontratës ka ndodhë një gabim teknik ku AK Komuna e Gjakovës ka mundur të kërkojë informacione shtesë për pretendimin e lartcekur. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit të ofertës së OE ankuesit lidhur me pretendimin e parë sqaron se, i njëjti në ofertë në Listën e ATK-së inxhinierin e ndërtimtarisë z.Xhavit Jasiqi e ka të deklaruar si punëtor primarë, dhe se ky pretendim i OE ankuesit nuk qëndron dhe se arsyeja e eliminimit për këtë pikë nga AK qëndron!



Lista e Punëtorëve

Periodha

2019

Numri Fiskal	811359274	Kontakt	SAHIT BERISHA
Tatimpaguesi	BERISHA COM SH.P.K.	Adresa	PN
Regjioni	GJAKOVË	Tel	044/179-573
Lloji Kompanisë	SH.P.K.	Aktiviteti	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

Nr.	Emri	Nr. Personal	Punëtor	MUJIT											
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	AGUSTIN SHALA	1001260444	JO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
2	ARDIT BERISHA	1233279770	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
3	BENRIDE BERISHA	1002677080	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
4	BENJAMIN RADI	1171941258	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
5	EGZON BERISHA	1243613163	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
6	FATMIR KRYEZIU	2003840487	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
7	ISLAM KUSHI	1171706209	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
8	ISTREF IDRIZAJ	1172881781	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
9	NEHRU MALOKU	1002333640	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
10	SAHIT BERISHA	1001265748	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
11	SAHIT BERISHA	1013409078	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
12	SHPEJTIM IDRIZAJ	1241232731	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
13	XHAVIT JASIQI	1003522489	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*

4/6/2020 9:46:44 AM

4/6/2020

Printing Report



Lista e Punëtorëve

Periodha

2020

Numri Fiskal	811359274	Kontakt	SAHIT BERISHA
Tatimpaguesi	BERISHA COM SH.P.K.	Adresa	PN
Regjioni	GJAKOVË	Tel	044/179-573
Lloji Kompanisë	SH.P.K.	Aktiviteti	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

Nr.	Emri	Nr. Personal	Punëtor	MUJIT											
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	AGUSTIN SHALA	1001260444	JO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
2	ARDIT BERISHA	1233279770	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
3	BENRIDE BERISHA	1002677080	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
4	BENJAMIN RADI	1171941258	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
5	EGZON BERISHA	1243613163	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
6	FATMIR KRYEZIU	2003840487	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
7	ISLAM KUSHI	1171706209	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
8	ISTREF IDRIZAJ	1172881781	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
9	NEHRU MALOKU	1002333640	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
10	SAHIT BERISHA	1001265748	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
11	SHPEJTIM IDRIZAJ	1241232731	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
12	XHAVIT JASIQI	1003522489	PO	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*

4/6/2020 8:51:23 AM

Autovinçi i cili e keni prezantuar është nën peshë minimale të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Përgjigje II: Ky pretendim i dhënë nga AK Komuna e Gjakovës nuk qëndron sepse ne e kemi prezantuar Autovinçin sipas kërkesës të FDT-së. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit të ofertës së OE ankuesit lidhur me pretendimin e dytë sqaron se, i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur kontratën mbi qiramarrjen për projektin në fjalë, mirëpo është nën peshën e lejuar, andaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron dhe se arsyeja e eliminimit për këtë pikë nga AK qëndron, shih mëposhtëm kërkesën e AK-së, librezën e makinerisë e cila tregon se pesha F1-pesha maksimale e ngarkesës së lejuar është 9430, ndërsa në kontratën mbi qiramarrjen është e deklaruar se është mbi 15 TON, mirëpo librezja shpjegon të kundërtën!

	lidhë kontratë)
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë a.) Një lugë Ngarkuese. b.) Një eskavatorë(makineri mr strukturë rrotulluese) me peshë mbi 16t c.) Një skavatorë(makineri mr strukturë rrotulluese) me peshë mbi 16t d.) Katër kamiona me konstruksion ndërtim kiper mbi 15t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) e.) Një rimorkio deri 40t f.) Një autokvinç mbi 15t g.) Një bunduzher mbi 15t	Lista e mjeteve-paisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njëërën prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (kopje).

A	Klasifikimi i punës, sipas sistemit të kodimit të punës	05-499-CG
I	Data e regjistrimit të punës	20-06-2016
C	Titulli i punës	Xhamaja
C2	Pjesë e punës	Faza
C2.1	Mënyra e punës	Taloç I Jerlive Ferizaj
C2.2	Data e regjistrimit të punës	23-12-1998
D	Mënyra e punës	MAN
D.1	Mënyra e punës	T 40
D3	Klasifikimi i punës, sipas sistemit të kodimit të punës	26-464
E	Data e regjistrimit të punës	1401385M267042
S	Titulli i punës	1998
S.1	Mënyra e punës	2
S.2	Mënyra e punës	24000
Q	Mënyra e punës	9430
F	Mënyra e punës	14570
F1	Mënyra e punës	
P	Mënyra e punës	12816
P1	Mënyra e punës	Dizel
P2	Mënyra e punës	E Katër
P3	Mënyra e punës	Kamion Vinç 2 Dyer
R	Mënyra e punës	
2A	Mënyra e punës	
Mënyra e punës		
Mënyra e punës		

KONTRATE QIRAJE

Data : 15.05.2020

QIRADHENESI : **Fazli Xhemajli** - Talinoc i Jerlive i regjistruar me Nr Personal: 1012662331 ne poziten e pronarit

QIRAMARRESI : **BERISHA COM SH.P.K.** - Gjakovë kompani e regjistruar me Nr Biznesi : 811359274 e cila përfaqësohet nga Z.Sahit Berisha.

OBJEKTI : Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-llegale dhe shërbime tjera 632-20-1610-5-2-1

Makineria : Autovinç mbi 15 Ton 

pronesine mbi te cilat e verteton me dokumentat bashkengjitur kesaj kontrate (libreza e automjetit)

Qiradhenesi deklaron se keto mjete ja jep me qira shoqerise **qiramarrese BERISHA COM SH.P.K. per** tenderin me

Titull : **Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-llegale dhe shërbime tjera 632-20-1610-5-2-1**

Qiramarresi eshte i detyruar ti ruaj, ti mirembaje mjetet e mesiperme, duke mos patur te drejte per tja dhe per njeqerje te tyre me njeqerje dhe ti ktheje ato ne perfundim te kontrates, ne qendrat teknike ne e

3.Bulldozherit i mungon Dudi Doganor Përgjigje III: Kërkesa nga AK Komuna e Gjakovës ka qenë:

“Lista e mjeteve-paisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbipronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave(sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjellësh dëshmi njëzëri prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t’i angazhoj për këtë projekt (kopje).

Ne e kemi dorëzuar Kontratë mbi shitblerjen e mjetit. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit të ofertës së OE ankuesit lidhur me pretendimin e tretë sqaron se, i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur kontratën mbi shitblerjen, ndonëse kontrata nuk shpjegon peshën e ngarkesës, mirëpo AK konform nenit 72 ka mundur që të kërkoj sqarime, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i qëndrueshëm.

KONTRATË MBI SHITBLERJEN

Sot me 18.05.2015 në Junik lidhet kjo kontratë në mes të palëve:

1. **"Joos&Krasniqi-Bazë"** Sh.P.K.me addressë në Junik, me nr fiskal: 600490198, te cilën e përfaqëson Agron Krasniqi-Drejtorë dhe tutje Blerësi, dhe
2. Ndue Koni nga Gjakovë, rruga "Pjeter Bogdani" nr.16 me nr Personal: 1009360570 këtë e tutje Shitësi.

Palët u dakorduan si në vijim:

Neni 1
Shitësi shet Blerësit:

Buldozerin Marka Fiat – Hitachi tip D150LGP ngjyre portokalli V.P. 2000 me nr te shasisë:192104-76042579A5 ulese 1 me kabine dyer 2.

Neni 2
Shuma e vlerës se këtij mjeti është 7,000.00 Euro (Shtatemijeeuro). Pagesa bëhet përmes xhirlogarisë me nr: BKT4191 8525 1318 4692, jo më vonë se 30 dite nga data e nënshkrimit te kësaj marrëveshje.

Neni 3
Çdo mosëmarrëveshje apo kontest në mes të palëve kompetente për zgjidhjen e kontesteve është Gjykata Komunale në Gjakovë.

Neni 4
Kjo kontratë përpilohet vetëm në gjuhën shqipe dhe në katër (4) kopje ku të dyja palët e nënshkruajnë me nënshkrimet e tyre. Në rast përkthimi në ndonjë gjuhë tjetër për bazë merret vetem gjuha shqipe.

Neni 5
Palët me nënshkrimin e kësaj kontrate pranojnë nenet dhe kushtet e kësaj kontrate.

Si përfundim ekspertja shqyrtuese sqaron se, ky aktivitet siç e potencuam edhe më lartë, është kthyer në rivlerësim konform vendimit PSH 1126/20 i dt:03.01.2021 ku AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarimet, dhe ka marrë përgjigjet! Meqenëse GOE i rekomanduar është me çmimin më të ulët dhe se kriteret kyçe i plotëson, sa i përket vazhdimit të validitetit të kamionëve, nuk mendoj se duhet të eliminohet, pasi që edhe këtë kriter tani e ka përmbushur, po ashtu në ofertë GOE ka të bashkangjitur edhe një Lopatë ngarkuese së bashku me ekskavatorin me zingjirë, e cila është e dokumentuar me DUD Doganor si dhe me faturë të shitblerjes Bejta Commerce Sha dhe Nëntë Vëllezërit SHPK, gjersa lidhur me dokumentimin e pajisjeve dhe makinerive, në ofertën e GOE të rekomanduarit janë të bashkangjitura marrëveshjet mbi qiramarrjen, marrëveshjet mbi shitblerjen si dhe faturat e blerjeve për pajisjet dhe makineritë përkatëse! Andaj mendoj se vendimi i AK-së të mbetet në fuqi, ndërsa ankesa e OE ankues të refuzohet.

Nr. i prokurimit	632-20-1610-5-2-1
Nr i brendshëm	632-20-014-521

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Company Murseli SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Dogana Kaçanike, 70520, DOGANAJ	145.475,00€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh., Marash - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k., Sadik Stavileci, 50000, Gjakove	68.998,80€
3.	VB. TOFAJ, QENDËR, -51050, JUNIK	170.000,00€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik BERISHA COM SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI-BAZE SH.P.K., GJAKOVË, 50000, UJEZ	157.135,00€
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K, Madanaj, 50000, Gjakove	89.105,00€
6.	Lulzim Beqiraj B.I., Rr. Arben Qerimaj , Nr 180, 51000, Deçan	94.155,00€

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Gjakove shpërblen me kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. "Eltoni Com"; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; EUROCOM SH.P.K, Madanaj, 50000, Gjakove, në vlerë totale të ofertës **89.105,00€**

Data: 16.02.2021

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet dhe se vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë 05.03.2021, dhe me 11.03.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori ekonomik "Horn & Co.Kosova" SH.P.K. & "Company Murseli" SH.P.K.-Deçan, me datë 05.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Berisha Com" SH.P.K.-Gjakovë me datë 15.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr.213/21 TË DT.11.03.2021

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr.213/21 të dt.11.03.2021 dhe në vazhdim po i japim përgjigjet lidhur me konstatimet e ekspertës shqyrtuese të OSHP-së. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese të OSHP-së në lidhje me pretendimin tonë ankimor se Konzorciumi i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse OE Company Bejta Commerce sh.a është caktuar si lider i grupit, mirëpo në lidhje e ofertës figuron si lider OE N.P.SH. “Eltoni Com” dhe se deklaratat nën betim nuk janë të marrura nga dosja e tenderit të cilave ju mungon titulli i projektit dhe nr. i aktivitetit, ndërsa ekspertja shqyrtuese sa i përket këtij pretendimi tonë ankimor e ka cituar një konstatim të panelit shqyrtues të OSHP-së në të cilin konstatim OSHP-ja i është drejtuar KRPP-së në lidhje me këtë pretendim tonin ankimor. Mirëpo KRPP-ja në interpretimin e saj e cek se sipas KRPP-së një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël dhe thotë se AK-ja duhet të vendos vet se a mund të konsiderohet devijim i vogël apo jo. Ekspertja shqyrtuese e cek se sa i përket deklaratës nën betim KRPP-ja e konsideron si devijim të vogël i cili duhet të mbetet në diskrecion të AK-së.

Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron për faktin se nuk mund të konsiderohet si devijim i vogël fakti se deklaratat nën betim nuk janë të marrura nga dosja e tenderit e aq më tepër fakti se këtyre deklaratave ju mungon titulli i aktivitetit të prokurimit dhe numri i prokurimit, pasi që si mund të dihet se për cilin aktivitet të prokurimit janë bërë këto deklarata. Pra ky arsyetim i ekspertet shqyrtuese është i pa bazuar. Gjithashtu ekspertja shqyrtuese nuk e ka marr fare parasysh pretendimin tonë ankimor se OE Bejta Commerce sh.a është caktuar si lider i grupit, mirëpo në lidhje e ofertës figuron si lider OE N.P.SH. “Eltoni Com”. Ekspertja shqyrtuese ju ka referuar vetëm pretendimit tonë në lidhje me deklaratat nën betim mirëpo pretendimin në lidhje me liderin e konzorciumit nuk e ka marrë parasysh që tregon qartë se përderisa edhe ekspertja shqyrtuese nuk e ka shqyrtuar këtë pretendim, shihet qartë se pretendimi ynë ankimor është i bazuar. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese sa i përket pretendimit tonë ankimor se OE Company Bejta Commerce Sh.a në deklaratën e Konzorciumit është me seli në Prishtinë ndërsa në deklaratën nën betim del të jetë Komuna e Gjilanit, ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se ky pretendim i yni është i pa bazuar sepse ky devijim mund të jetë një gabim teknik, por që vërtetohet në certifikatën e biznesit. Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese është absurd për faktin se ekspertja shqyrtuese nuk e ka për detyrë të tregoj se a është devijim apo lëshim teknik nga kompania, mirëpo në këtë rast ekspertja shqyrtuese është dashur të konstatoj se a është i bazuar pretendimi ynë ankimor apo jo dhe jo të konstatoje se ky mund të jetë një lëshim teknik. Pra në këtë rast po favorizohet OE i rekomanduar për kontratë, sepse si mund ta dijë ekspertja shqyrtuese se ky devijim sipas ekspertës është lëshim teknik nga kompani. Po ashtu ekspertja shqyrtuese e cek se faktin se pretendimi ynë ankimor është i pa bazuar vërtetohet tek certifikata e biznesit, mirëpo ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron sepse nëse do të ishte ashtu atëherë nuk do të kërkoheshin fare të dhënat e kompanisë në deklaratën nën betim, apo tek deklarata e konzorciumit, mirëpo do të vërtetoheshin në Certifikatën e Biznesit. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese në lidhje me pretendimin tonë ankimor se diploma e inxhinierit Muhamet Selimi është e pa verifikueshme-nuk lexohet, ku ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor është i pa

bazuar sepse diplomën dh të gjitha referencat dhe kualifikimet për inxhinierin në fjalë janë të noterizuara dhe janë të vlefshme. Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron për faktin se ekspertja shqyrtuese nuk ka konstatuar se a është apo jo diploma e verifikueshme mirëpo e ka cekur se diploma dhe kualifikimet me referenca për inxhinierin janë të noterizuara. Ekspertja shqyrtuese është dashur të konstatoj se a është apo jo e verifikueshme diploma, ndërsa nëse eventualisht ekspertja shqyrtuese do të konstatonte se diploma është e verifikueshme atëherë është dashur ta bashkëngjis diplomën sikurse i ka bashkëngjitur disa prej dëshmimeve në pretendimet tjera ankimore. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese sa i përket pretendimit tonë ankimor se inxhinierit Izajdin Sylaj – Gjeodet i ka skaduar licenca, ndërsa ekspertja shqyrtuese ju ka referuar vendimit të panelit shqyrtues në të cilin vendim është cekur se licencat nuk janë kërkuar në dosje të tenderit të jenë valide. Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron sepse në vendimin e panelit shqyrtues të cilit ju ka referuar ekspertja nuk janë shqyrtuar në tërësi faktet dhe dëshmitë tona, sepse është absurd fakti të ofrohet një gjeodet me licencë të skaduar-jo valide, sepse licenca e tregon fakti se gjeodeti mund të kryej apo jo punë. Në këtë rast përderisa licenca është jo valide, atëherë është absurd fati të arsyetohet se kinse nuk është kërkuar në dosje të tenderit. Pra nëse do të ishte ashtu atëherë i bie që afati i licencës nuk ka kurrfarë vlere, e rëndësishme është vetë licenca, mirëpo përderisa nuk ka afat ajo licencë është e pavlefshme. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese të OSHP-së, në lidhje me pretendimin tonë ankimor se OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë disa prej makinerive , e disa prej tyre i ka prezantuar pa regjistrim, ndërsa disa tjera nuk i ka ofruar me peshën e kërkuar, ku ekspertja shqyrtuese këtë pretendim ankimor tonin e ka cilësuar si të pa bazuar duke ju referuar kërkesës për sqarime shtesë nga ana e AK-së dhe pas kësaj kërkesë për sqarime ekspertja konstaton se OE i rekomanduar për kontratë i ka bashkëngjitur librezat me validitet. Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron për faktin se ekspertja shqyrtuese ashtu siç e ka bashkëngjitur kërkesën për sqarime shtesë është dashur ti paraqes edhe librezat të cilat sipas saj janë valide. Gjithashtu ekspertja shqyrtuese askund nuk e cek se OE i rekomanduar për kontratë e ka ofruar lug ngarkuesin dhe gjithashtu askund nuk e cek se Rimorkio me targa 06-408-XB është konform kërkesës së FDT-së në lidhje me peshën, andaj ky veprim nga na e ekspertës shqyrtuese e tregon qartë faktin se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka ofruar të gjitha pajisjet e kërkuara. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese në lidhje me pretendimin tonë ankimor se kinse inxhinieri i prezantuar nga ne z. Xhavit Jasiqi është punëtor primar dhe i njëjti punon në KK Junik në punë të rregullt zyrtare. Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron për faktin se në lidhje me inxhinierin të cilin e kemi prezantuar si primar, ju sqarojmë se ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë pasi që inxhinieri i prezantuar nga ne është punëtor sekondar. Gjithashtu vlen të ceket fakti se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që nuk guxon të prezantohet një punëtor i cili mban dy punë, andaj edhe konstatimi i ekspertës shqyrtuese është i pa bazuar dhe nuk qëndron. Nuk pajtohem me konstatimin e ekspertës shqyrtuese në lidhje me pretendimin tonë ankimor ku e kemi cekur se ne e kemi dorëzuar kontratën mbi shitblerjen e Bulldozherit për te cilin jemi eliminuar se kinse na mungon

ky mjet, ndërsa ekspertja shqyrtuese e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si pjesërisht të bazuar duke thënë se kontrata e prezantuar nuk e shpjegon peshën e ngarkesës. Ky konstatim i ekspertës shqyrtuese nuk qëndron për faktin se përderisa e kemi prezantuar kontratën për mjetin për të cilin jemi eliminuar se kinse ne nuk e kemi dhe ekspertja shqyrtuese e ka pranuar këtë fakt atëherë është dashur ta cilësoj pretendimin tonë ankimor si të bazuar, mirëpo ekspertja shqyrtuese nuk e ka bërë një veprim të tillë por e ka cekur se kontrata nuk e shpjegon peshën e ngarkesës. Pra ne jemi eliminuar se kinse nuk e kemi prezantuar dudin doganor, ndërsa ekspertja shqyrtuese e cek se kontrata nuk e tregon peshën. Ekspertja shqyrtuese është dashur të konstatoj se a qëndron apo jo pretendimi ynë ankimor në lidhje me kontratën e prezantuar nga ne, mirëpo nuk është në kompetencën e saj të nxjerr arsyetime tjera se a është plotësuar pesha apo jo, pasi që nuk kjo nuk ka qenë arsye e eliminimit tonë dhe as pretendim i yni ankimor. Pra me këtë veprim ekspertja shqyrtuese i ka kaluar kompetencat e saj edhe pse vetëm është dashur të konstatoj se a është përmbushur apo jo kërkesa nga ana jonë. Gjithashtu ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se meqenëse OE i rekomanduar për kontratë është me çmim më të ulët dhe se kriteret kyçe i plotëson, sa i përket vazhdimit të validitetit të kamionëve, nuk mendoj se duhet të eliminohet, pasi që edhe këtë kriter tani e ka përmbushur. Pra me këtë konstatim të ekspertës shqyrtuese shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm, sepse nuk ka mundësi që tani të përmbushen kërkesat e dosjes së tenderit përderisa më herët ky OE ka qenë i përgjegjshëm pra nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Gjithashtu duke u bazuar në konstatimin e ekspertës shqyrtuese po vërehet qartë se kamionët nuk kanë qenë të regjistruar para datës së hapjes mirëpo e cek se është bërë vazhdimi i validitetit të kamionëve. Pra në këtë rast ekspertja shqyrtuese po bie në kundërshtim me konstatimet e saj, ku më lart e cek se OE i rekomanduar për kontratë e përmbush kërkesën në lidhje me pajisjet, ndërsa tani e cek se tani OE i rekomanduar për kontratë e ka përmbushur kriterin në lidhje me validitetin e kamionëve. Ju sqarojmë se neni 60 i LPP-së e cek shumë qartë se duhet të rekomandohet për kontratë tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Horn & Co.Kosova"SH.P.K. & "Company Murseli" SH.P.K.-Deçan

Pas shqyrtimit të shkresave për këtë aktivitet të prokurimit dhe ecurisë së këtij aktiviteti të prokurimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me njoftimin për kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020, kurse me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k. Mirëpo, pas ankesave dhe vendimit të PSh.NR.370/20 të datës 09.07.2020, ky aktivitet është kthyer në rivlerësim. Pas procesit të rivlerësimit, AK me datë 23.07.2020 rekomandon po të njëjtin grup të operatorëve ekonomik "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, përderisa përsëri me shqyrtimin e ankesës në OSHP, ky aktivitet i prokurimi është kthyer në rivlerësim me vendimin PSh.Nr.550/20 të datës 28.09.2020. Ndërsa, me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit, AK ka rekomanduar përsëri grupin e operatorëve ekonomik "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, kurse, përsëri me shqyrtimin e ankesës në OSHP me vendimin PSh.Nr.1126/20 të datës 03.02.2021 është obliguar AK që përsëri ta kthen në rivlerësim, ku me datë 16.02.2021 AK ka publikuar vendimin duke rekomanduar përsëri grupin e operatorëve ekonomik "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, përderisa OE ankuesi "HORN& Co. Kosova" SHPK & Company Murseli SH.P.K. ka bërë ankesë në OSHP me datë 25.02.2021 me pretendimet se grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k, nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë: 1. Në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 & 9.2 pika a), ku është kërkuar se: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë: a.) Një lugë Ngarkuese. OE ankues në nakesë ka cekur se pas verifikimit të dokumenteve lidhur me këtë pikë kemi vërtetuar se operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë "COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A.; N.P.SH. "Eltoni Com" dhe EUROCOM SH.P.K, nuk e posedojnë asnjë dokument që vërteton se ka Lugë Ngarkuese në pronësi apo me qira. (Këtë e kemi vërtetuar nga dokumentet e marra nga Autoriteti Kontraktues, pas kërkesës për qasje në dokumentet zyrtare).

2.Në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 & 9.2 pika d) ku është kërkuar se: Katër (4) kamionë me konstruksion ndërtim kiper mbi 15t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) - Ndërsa ne pas verifikimit të dokumenteve lidhur me këtë pikë kemi vërtetuar se Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë i ka kampionat në pronësi apo me qira, mirëpo të gjithë këta kampionat ofruar Nuk kanë fare afat valid të regjistrimit (iu ka skaduar regjistrimi) e cila gjë mund të vërtetohet nga CERTIFIKATA E REGJISTRIMITTE

AUTOMJETEVE të dorëzuara nga Operatori Ekonomik. 3.Po ashtu gjatë kontrollit dhe shqyrtimit të dokumentacionit kemi hasur edhe në mospërputhje të informatave në Listën e Makinerive dhe dokumenteve të prezantuara nga Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë, sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 & 9.2, ku është kërkuar se: Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit).

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankuesit kundër grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduarin lidhur me pajisjet, kamionët dhe dokumentet apo dëshmia e tyre mbi qiramarrjen apo dokumente mbi posedimin e tyre, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se këto pretendime janë shqyrtuar tri herë radhazi, ku OSHP ka obliguar AK-në që gjatë procesit të rivlerësimit të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së, dhe po ashtu edhe hera e fundit në vendimin e PSH 1126/20 dt. 03.02.2021 ky aktivitet është kthyer në rivlerësim duke e obliguar AK-në që lidhur me këto pretendime të kërkoj sqarime. AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarime nga GOE i rekomanduar si me larte.

GOE i rekomanduar ju ka përgjigjur AK-së në afat ligjor duke i bashkangjitur librezat me validitet.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese tutje sqaron se ky aktivitet siç është potencuar edhe më lartë, është kthyer në rivlerësim, ku AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarimet, dhe ka marrë përgjigjet. Meqenëse grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar është me çmimin më të ulët dhe se kriteret kyçe i plotëson, sa i përket vazhdimit të validitetit të kamionëve, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese vlerëson se nuk duhet të eliminohet, pasi që edhe këtë kriter tani e ka përmbushur. Po ashtu në ofertë grupi i OE ka të bashkangjitur edhe një Lopatë ngarkuese së bashku me eskavatorin me zingjirë, e cila është e dokumentuar me DUD Doganor si dhe me faturë të shitblerjes Bejta Commerce Sha dhe Nëntë Vëllezërit SHPK. Sa i përket pretendimit lidhur me dokumentimin e pajisjeve dhe makinerive, në ofertën e grupit të OE të rekomanduar janë të bashkangjitura marrëveshjet mbi qiramarrjen, marrëveshjet mbi shitblerjen si dhe faturat e blerjeve për pajisjet dhe makineritë përkatëse. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese vlerëson se vendimi i AK-së duhet të mbetet në fuqi.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Berisha Com" SH.P.K.-Gjakovë

Pas shqyrtimit të shkresave për këtë aktivitet të prokurimit dhe ecurisë së këtij aktiviteti të prokurimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datë 24.04.2020 me njoftimin për kontratë, ku hapja e ofertave është bërë me datë 18.05.2020, kurse me datë 28.05.2020 AK ka rekomanduar për kontratë "COMPANY BEJTA COMMERCE" SH.A. & N.P.SH. "Eltoni Com" & "Eurocom" Sh.p.k. Mirëpo, pas ankesave dhe vendimit të PSh.NR.370/20 të datës 09.07.2020, ky aktivitet është kthyer në

rivlerësim. Pas procesit të rivlerësimit, AK me datë 23.07.2020 rekomandon po të njëjtin grup të operatorëve ekonomik “COMPANY BEJTA COMMERCE” SH.A. & N.P.SH. “Eltoni Com” & “Eurocom” Sh.p.k, përderisa përsëri me shqyrtimin e ankesës në OSHP, ky aktivitet i prokurimi është kthyer në rivlerësim me vendimin PSh.Nr.550/20 të datës 28.09.2020. Ndërsa, me datë 08.12.2020 gjatë procesit të rivlerësimit, AK ka rekomanduar përsëri grupin e operatorëve ekonomik “COMPANY BEJTA COMMERCE” SH.A. & N.P.SH. “Eltoni Com” & “Eurocom” Sh.p.k, kurse, përsëri me shqyrtimin e ankesës në OSHP me vendimin PSh.Nr.1126/20 të datës 03.02.2021 është obliguar AK që përsëri ta kthen në rivlerësim, ku me datë 16.02.2021 AK ka publikuar vendimin duke rekomanduar përsëri grupin e operatorëve ekonomik “COMPANY BEJTA COMMERCE” SH.A. & N.P.SH. “Eltoni Com” & “Eurocom” Sh.p, përderisa OE ankues “Berisha Com” SHPK. ka bërë ankesë në OSHP me datë 06.03.2021, ku pretendon se grupi i OE të rekomanduar nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tyre mungojnë: AK gjatë Rivlerësimit nuk i ka marrë për bazë pretendimet tona në lidhje me ankesën që kemi bërë dhe si ka shqyrtuar. Koncerziumi i rekomanduar për shpërbllim me kontratë “COMPANY BEJTA COMMERCE” SH.A; N.P.SH. “Eltoni Com”; “Eurocom” Sh.p.k. është i pa përgjegjshëm, për arsye se këtij koncerziumi i mungojnë këto dokumente të cilat i ka dëshmuar edhe Raporti i Ekspertit, si dhe vendimi i OSHP-së. Dokumente të cilat i mungojnë Koncerziumit janë:

Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. “Eltoni Com”. Deklaratat Nën Betim të paraqitur në dosjen e tenderit nuk janë të marruara nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe nr. i prokurimit. PSH550/20 i dt:28.09.2020

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Berisha Com” sh.p.k – Gjakovë se gjatë qasjes në dokumentet e konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës “Company Bejta Commerce Sh.A”; N.P.SH. “Eltoni Com”; “Eurocom” Sh.p.k., ku Company Bejta Commerce Sh.A. është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës e shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. “Eltoni Com” dhe deklaratat nën betim të paraqitur në dosje të tenderit nuk janë marrë nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe numri i projektit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se OE Eltoni me datë 15.07.2020 i është drejtuar KRPP-së për interpretim me titull “Kërkesë për interpretim të lidhur me Aneksin 2-Deklarata nën Betim dhe Marrëveshjen e Konzorciumit”. Kurse, me datë 29.07.2020 KRPP-ja i kthen përgjigje duke dhënë sqarime lidhur me par. 4 të nenit 59 të LPP-së, 47.19 dhe 47.21 të RRUOPP-së, Konkretisht, KRPP-ja i jep këtë sqarim anëtarit të konzorciumit: “edhe pse për KRPP-ën një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale të dosjes së tenderit, megjithatë sipas paragrafit të lartë cituar Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, Pra ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se sa i përket deklaratës nën betim, KRPP e konsideron si devijim të vogël, i cili duhet të mbetet në diskrecion të AK-së. Kompania “COMPANY BEJTA

COMMERCE” SH.A në deklaratën e Koncerziumit është me seli në Prishtinë ndërsa në Deklaratën Nën Betim del të jetë nga Komuna e Gjilanit. PSH.370/20 dt: 09.07.2020

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A në deklaratën e Koncerziumit është me seli në Prishtinë ndërsa në Deklaratën Nën Betim del të jetë nga Komuna e Gjilanit. **Paneli shqyrtues** konform ekspertit shqyrtues konstaton se **nuk është i bazuar** ky pretendim për arsye se ky devijim mund të jetë një gabim teknik, por që vërtetohet në Certifikatën e Biznesit.

Deklaratat Tatimore Vjetore i ka paraqitur vetëm kompania “COMPANY BEJTA COMMERCE” SH.A ndërsa kompanitë tjera të cilat janë në koncerzium këto dokumente iu mungojnë në Dosjen e Tenderit. PSH. 370/20 i dt: 09.07.2020.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se **Deklaratat Tatimore Vjetore** i ka paraqitur vetëm kompania COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A ndërsa kompanitë tjera të cilat janë anëtare të koncerziumit, këto dokumente ju mungojnë në Dosjen e Tenderit. **Paneli shqyrtues** konform ekspertit shqyrtues konstaton se **ky pretendim është i pa bazuar** sipas dispozitës ligjore të LPP-së neni 71 pika 4, për faktin se në paragrafin e lartpërmendur thuhet se citat: “...Çdo kërkesë vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2,68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”, prandaj në rastin konkret deklarata tatimore vjetore e ka dorëzuar njeri nga anëtarët e konzorciumit dhe se vijnë në përfundim se kërkesa e lartcekur është plotësuar nga konzorciumi në fjalë.

Inxh Muhamet Selimi e ka diplomën të pa verifikueshme - nuk lexohet. PSH 370/20 i dt:09.07.2020

Ndërsa **është i pa qëndrueshëm pretendimi i ankuesit sa i përket Inxh inierit Muhamet Selimi**, kjo për faktin se diplomën dhe të gjitha referencat dhe kualifikimet për inxhinierin në fjalë janë të noterizuara dhe janë të vlefshme.

Inxhinierët si Izajdin Sylaj Gjeodeti, është Gjeodet të cilit i ka skaduar Licenca, Ju mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovës. PSH. 1126/20 i dt:03.01.2021

Paneli shqyrtues konform ekspertes Shqyrtuese sqaron se: sa i përket Licencës po ashtu AK në Njoftimin për kontratë nuk ka cekur se kërkohet **Licenca valide**, andaj pretendimi **nuk gjendet i bazuar**. Ndërsa sa i përket kontratave të punëtorëve, GOE i rekomanduar ka bashkangjitur kontratat e punëtorëve në E-prokurim me datë 30.11.2020, dhe shihet se kontratat janë valide dhe vërtetohet **se këto kontrata kanë qenë para hapjes si dhe nuk paraqesin ndryshim material konform LPP-së dhe Rruopp-së, sepse nuk janë kontrata mbi veprë por janë kontrata pune me kohë të caktuar/pacaktuar të nënshkruara kryesisht para hapjes e cila është e dëshmuar edhe me listën e ATK-së.**

Ky koncerzium ka mungesa edhe tek makineritë si:

- 1 Lug Ngarkues Mungon.
- Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim

- Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim
- Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshën e kërkuar në Dosjen e Tenderit

PSH. 1126/20 i dt:03.01.2021

Si përfundim, Paneli shqyrtues konform ekspertës Shqyrtuese i rekomandon AK-së, që procesin e rivlerësimit ta bëjë konform LPP-së dhe Rruopp-së, duke respektuar vendimet e OSHP-së 370/20 dhe 550/20, gjithashtu sa i përket makinerisë sipas pretendimit të fundit për GOE të rekomanduarin, AK të verifikoj dhe analizoj se a i përmbushin kriteret sipas FDI-së pasi që në ofertën e GOE të rekomanduarit ka më tepër makineri të ofruara se sa që kërkohet nga AK, andaj AK të përqendrohet tek kërkesa sipas FDI-së. Po ashtu në raport të rivlerësimit të bëjë sqarimin e qartë me rastin e eliminimit dhe përzgjedhjes së Ofertuesve, pasi që AK në kërkesat për rishqyrtim të OE ankuesit nuk ka dhënë sqarimet e detajuara dhe përgjigje në pretendimet, me qëllim që ofertuesit/ankuesit të mirëkuptojnë vendimin e AK-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE ankues kundër grupit të OE të rekomanduarin lidhur me pajisjet, kampionat dhe dokumentet apo dëshmia e tyre mbi qiramarrjen apo dokumente mbi posedimin e tyre, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se këto pretendime janë shqyrtuar tri herë radhazi, ku OSHP ka obliguar AK-në që gjatë procesit të rivlerësimit të kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së, dhe po ashtu edhe hera e fundit në vendimin e PSh.Nr.1126/20 të datës 03.02.2021, ky aktivitet është kthyer në rivlerësim duke e obliguar AK-në që lidhur me këto pretendime të kërkoj sqarime. AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarime nga grupi i OE të rekomanduar si me lartë.

Grupi i OE të rekomanduar ju ka përgjigjur AK-së në afate ligjor duke i bashkangjitur librezat me validitet. Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese tutje sqaron se të gjitha pretendimet e lartpërmendura nga OE ankues kundër grupit të OE të rekomanduarit, ritheksojmë sërish se janë shqyrtuar thuajse tri herë radhazi dhe të gjitha kanë vendime nga OSHP, PSh.Nr.550/20 i datës 28.09.2020, PSh.Nr.1126/20 i dt. 03.01.2021, dhe se vlen të ceket se pretendimet lidhur me makineritë janë sqaruar të fundit në vendimin PSh.Nr.1126/20 i dt. 03.01.2021, dhe paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese vlerëson se këto pretendime janë të gjykuara tashmë.

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit kundër AK-së lidhur me arsyet e eliminimit:

Në këtë Rivlerësim AK Komuna e Gjakovës edhe ne si Koncerzium “Berisha Com”Sh.p.k & “Joos & Krasniqi-Bazë”Sh.p.k na eliminon për arsye si: 1.Keni prezantuar inxhi. Diplomuar të Ndërtimtarisë (Xhavit Jasiqi) me kontratë të rregullt si të punësuar primar dhe i njëjti është i punësuar në KK-Junik në punë të rregullt zyrtare. Përgjigje I: z.Xhavit Jasiqi Inxhi. i Diplomuar i Ndërtimtarisë është i punësuar në kompaninë “Berisha Com”Sh.p.k ku mund ta shihni edhe në listën e pagave nga Administratë Tatimore e Kosovës, sa i përket

kontratës ka ndodhë një gabim teknik ku AK Komuna e Gjakovës ka mundur të kërkojë informacione shitesë për pretendimin e lartcekur. Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese pas analizimit të ofertës së OE ankues lidhur me pretendimin e parë sqaron se, i njëjti në ofertë në Listën e ATK-së inxhinierin e ndërtimtarisë z. Xhavit Jasiqi e ka të deklaruar si punëtor primar, dhe se ky pretendim i OE ankuesit nuk qëndron dhe se arsyeja e eliminimit për këtë pikë nga AK qëndron!

Autovinçi i cili e keni prezantuar është nën peshë minimale të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Përgjigje II: Ky pretendim i dhënë nga AK Komuna e Gjakovës nuk qëndron sepse ne e kemi prezantuar Autovinçin sipas kërkesës të FDT-së. Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese pas analizimit të ofertës së OE ankues lidhur me pretendimin e dytë sqaron se, i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur kontratën mbi qiramarrjen për projektin në fjalë, mirëpo është nën peshën e lejuar, andaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron dhe se arsyeja e eliminimit për këtë pikë nga AK qëndron, shih mëposhtëm kërkesën e AK-së, librezën e makinerisë e cila tregon se pesha F1-pesha maksimale e ngarkesës së lejuar është 9430, ndërsa në kontratën mbi qiramarrjen është e deklaruar se është mbi 15 TON, mirëpo librezja shpjegon të kundërtën!

	lidhë kontratë)
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë a.) Një lugë Ngarkuese. b.) Një eskavatorë(makineri mr strukturë rrotulluese) me peshë mbi 16t c.) Një skavatorë(makineri mr strukturë rrotulluese) me peshë mbi 16t d.) Katër kamiona me konstruktion ndërtim kiper mbi 15t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) e.) Një rimorkio deri 40t f.) Një autokvinç mbi 15t g.) Një bunduzher mbi 15t	Lista e mjeteve-paisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njëzën prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (kopje).

A	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	05-499-CG
I	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	20-06-2016
C	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	Xhavit Jasiqi
C2	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	Fazë
C2.1	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	Talnoc 1 Jerlive Ferizaj
C2.2	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
C2.3	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
B	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	23-12-1998
D	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	MAN
D.1	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	MAN
D.2	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	T 40
D3	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	26-464
E	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	1001401385M267042
S	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	1998
S	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	2
S.1	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
S.2	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
Q	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	24000
F	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	9430
F1	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	14570
G	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
K	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
P	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	12816
P1	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	Dizel
P2	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	E Kallër
P3	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	Kamion Vinq 2 Dyer
R	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	
2A	Niveli i regjistrimit Kopje e regjistrimit Kopje e regjistrimit	

KONTRATE QIRAJE

Data : 15.05.2020

QIRADHENESI : **Fazli Xhemajli** - Talinoc i Jerlive i regjistruar me Nr Personal:1012662331 ne pozitën e pronarit

QIRAMARRESI : **BERISHA COM SH.P.K.** - Gjakovë kompani e regjistruar me Nr Biznesi : 811359274 e cila përfageshet nga Z.Sahit Berisha.

OBJEKTI : Rrërimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-llegale dhe shërbime tjera 632-20-1610-5-2-1

Makineria : Autovinq mbi 15 Ton 

pronesine mbi te cilat e verteton me dokumentat bashkengjitur kesaj kontrate (libreza e automjetit)

Qiradhenesi deklaron se keto mjete ja jep me qira shoqerise **qiramarrrese BERISHA COM SH.P.K.** per tenderin me

Titull : **Rrërimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-llegale dhe shërbime tjera 632-20-1610-5-2-1**

Qiramarrresi eshte i detyruar ti ruaj, ti mirembaje mjetet e mesiperme, duke mos patur te drejte per tja dhene nomenclature te kete me nomenclature dhe kufizime ato ne perfundim te kontrates, ne gjendjen teknike me q

3.Bulldozherit i mungon Dudi Doganor Përgjigje III: Kërkesa nga AK Komuna e Gjakovës ka qenë:

“Lista e mjeteve-paisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbipronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave(sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjellësh dëshmi njëzë prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë përblerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t’i angazhoj për këtë projekt (kopje).

Ne e kemi dorëzuar Kontratë mbi shitblerjen e mjetit. Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese pas analizimit të ofertës së OE ankuesit lidhur me pretendimin e tretë sqaron se, i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur kontratën mbi shitblerjen, ndonëse kontrata nuk shpjegon peshën e ngarkesës, mirëpo AK konform nenit 72 ka mundur që të kërkojë sqarime, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i qëndrueshëm.

KONTRATË MBI SHITBLERJEN

Sot me 18.05.2015 në Junik lidhet kjo kontratë në mes të palëve:

1. "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.P.K.me adrese në Junik, me nr fiskal: 600490198, te cilën e përfaqëson Agron Krasniqi-Drejtorkëtej e tutje Blerësi, dhe
2. Ndue Koni nga Gjakovë, rruga "Pjeter Bogdani" nr.16 me nr Personal: 1009360570 këtej e tutje Shitësi.

Palet u dakorduan si në vijim:

Neni 1
Shitësi shet Blerësit:

Buldozerin Marka Fiat – Hitachi tip D150LGP ngjyre portokalli V.P. 2000 me nr te shasisë:192104-76042579A5 ulese 1 me kabine dyer 2.

Neni 2
Shuma e vlerës se këtij mjeti është 7,000.00 Euro (Shtatemijeeuro). Pagesa bëhet përmes xhirollogarisë me nr: BKT4191 8525 1318 4692, jo më vonë se 30 dite nga data e nënshkrimit te kësaj marrëveshje.

Neni 3
Çdo mosëmarrëveshje apo kontest në mes të palëve kompetente për zgjidhjen e kontesteve është Gjykata Komunale në Gjakovë.

Neni 4
Kjo kontratë përpilohet vetëm në gjuhën shqipe dhe në katër (4) kopje ku të dyja palët e nënshkruajnë me nënshkrimet e tyre. Në rast përkthimi në ndonjë gjuhë tjetër për bazë merret vetem gjuha shqipe.

Neni 5
Palet me nënshkrimin e kësaj kontrate pranojnë nenet dhe kushtet e kësaj kontrate.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertës shqyrtuese, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, si dhe duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, vjen në përfundim se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka kërkuar sqarime shtesë konform konstatimeve në vendimet paraprake të Panelit Shqyrtues dhe AK ka marrë përgjigjet sipas sqarimeve të kërkuara. Po ashtu, sa i përket vazhdimit të validitetit të kamionëve, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK e plotëson këtë kriter, pastaj lidhur me lopatën ngarkuese siç ka qenë kërkesë, grupi i OE ka të bashkangjitur edhe një Lopatë ngarkuese së bashku me ekskavatorin me zingjirë, e cila është e dokumentuar me DUD Doganor, si dhe me faturë të shitblerjes Bejta Commerce Sha dhe Nëntë Vëllezërit SHPK, ndërsa lidhur me dokumentimin e pajisjeve dhe makinerive, në ofertën e grupit të OE të rekomanduarit janë të bashkangjitura marrëveshjet mbi qiramarrjen, marrëveshjet mbi shitblerjen, si dhe faturat e blerjeve për pajisjet dhe makineritë përkatëse. Andaj, Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh nenin 1 të LPP-së dhe duke pasur parasysh se grupi i

OE të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe se kriteret kyçe i plotëson, rezulton se AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së.


Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE "Horn & Co.Kosova" SH.P.K.
- 1x1 OE "Company Murseli" SH.P.K.-Deçan;
- 1x1 OE "Berisha Com" SH.P.K.-Gjakovë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.